

## Relacion – Tipi i kontratës - Shërbim

### **PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky relacion është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e thirrjes për punime)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS:** *“Punime rikonstruksioni në Qendrën Shtëpia e Ngjyrave”,*

#### **I. Argumentimi i specifikimeve teknike**

##### **PUNIME PRISHJEJE**

###### **Skeleritë**

Çdo skeleri e kërkuar duhet skicuar në përshtatje me KTZ dhe STASH. Një skelator kompetent dhe me eksperiencë, duhet të marrë përsipër ngritjen e skelerive që duhet të çdo tipi. Kontraktori duhet të sigurojë, që të gjitha rregullimet e nevojshme, që i janë kërkuar skelatorit të sigurojnë stabilitetin gjatë kryerjes së punës. Kujdes duhet treguar që ngarkesa e copërave të mbledhura mbi një skeleri, të mos kalojë ngarkesën për të cilën ato janë projektuar. Duhet marrë të gjitha masat e nevojshme që të parandalohet rënia e materialeve nga platforma e skelës. Skeleritë duhen të jenë gjatë kohës së përdorimit të përshtatshme për qëllimin për të cilin do përdoren dhe duhet të jenë konform të gjitha kushteve teknike.

Në rastin konkret të kryerjes së punimeve, meqë nuk jemi në anë të rrugës por Brenda në ambjentet e godinës, nuk ka nevojë për masa si veshja e skelerisë me rrjete mbrojtëse për të eliminuar rënien e materialeve dhe duke përfshirë shenjat sinjalizuese sipas kushteve të sigurimit teknik.

Skeleri çeliku të tipit këmbalëc, konform KTZ dhe STASH, duke përfshirë ndihmën për transport, mirëmbajtje, montim, ankorim, çmontime etj.

###### **Siguria në punë**

Kontraktori duhet të sigurohet se vendi dhe pajisjet janë:

- a) Të një tipi dhe standarti të përshtatshëm duke iu referuar vendit dhe llojit të punës që do të kryhet;
- b) Të siguruar nga një teknik kompetent dhe me ekperiencë;
- b) Të ruajtura në kushte të mira pune gjatë përdorimit.

Gjatë punës prishëse të gjithë punëtorët duhet të vishen me veshje të përshtatshme mbrojtëse ose mjete mbrojtëse si: helmata, syze, mbrojtëse, mbrojtëse veshësh, dhe sipas rastit edhe bombola frymëmarrjeje.

## **Metoda e prishjes**

Puna për prishje do të fillojë vetëm pasi të jenë stakuar energjia elektrike dhe rrjete të tjera të instalimeve ekzistuese të objektit.

Metodat e prishjes së pjesshme, duhet të jenë të tilla që pjesa e strukturës që ka mbetur të sigurojë qëndrueshmërinë e ndërtesës dhe të pjesëve që mbeten.

Kur prishja e ndërtesës ose e elementeve të saj nuk mund të bëhet pa probleme e ndarë nga pjesa e strukturës do të përdoret një metodë pune e përshtatshme.

Kur prishen elementët, duhen marrë masa për të mos rrezikuar elementët e tjerë konstruktive mbajtës, si dhe mos dëmtohen elementët e tjerë (si pjesë të muraturës, të suvasë që nevojitet të merremtohet si edhe dyshemesë së ambjenteve të brendëshme apo dyerve dhe dirtareve.

## **SUVATIMI I BRENDSHËM**

Sistemim i sipërfaqeve ku është e nevojshme për suvatime për nivelimet e parregullsive, me anë të mbushjes me llaç bastard me më shumë shtresa dhe copa tullash n.q.s është e nevojshme, edhe për zonat e vogla si dhe çdo detyrim tjetër për ta përfunduar plotësisht stukimin.

Përpara se të hidhet sprucimi duhet që sipërfaqja që do të suvatohet të laget mirë me ujë. Sprucim i mureve dhe tavaneve për muraturë të pastruar me llaç çimentoje të lëngët për përmirësimin e ngjitjes së suvasë dhe rforcimin e sipërfaqeve të muraturës, duke përfshirë skelat e shërbimit dhe çdo detyrim tjetër për ta përfunduar plotësisht sprucimin.

Suvatim me drejtues i realizuar nga një shtresë me trashësi 2 cm llaçi bastard m25 me përmbajtje për m<sup>2</sup>: rërë e larë 0,005 m<sup>3</sup>; llaç gëlqereje m- 1 : 2, 0.03 m<sup>3</sup>; çimento 400, 6.6 kg; ujë, i aplikuar me paravendosje të drejtuesve në mure (shirtit me llaç me trashësi 15 cm çdo 1 deri në 1,5 m ), dhe e lëmuar me mistri e bërda, duke përfshirë skelat e shërbimit si dhe çdo detyrim tjetër për ta përfunduar plotësisht suvatimin.

Suvatim shpatulla dyer, dritare, qepena. Para se të fillohen punimet aty ku tregohet në plane apo udhezohet nga Supervizori i objektit, Sipërmarrësi do të kontrollojë në objekt të gjitha zonat në të cilat do të realizohet shpatullimi. Në prezencë të Supervizorit të punimeve mbahet një proces-verbal për sasinë e sipërfaqes e cila do realizohet nderhyrja. Gjate procesit të shpatullimit duhet të kihet kujdes në afërsi të kornizave të dritareve në mënyrë që të mos humbasin dhe dëmtohen këta element nga rritja e trashësisë së suvatimit apo nga punimi i keq.

## **TAVANI/MURRET ME GIPS**

1. Parapërgatitja e sipërfaqes: Instalimi i pllakave të gipsit duhet të përfundojë duke siguruar qëndrueshmërinë e tyre, duke u mbështetur në struktura mbajtëse ekzistuese dhe si rezultat i kësaj sipërfaqja ku do të aplikohet duhet të jetë e pastër, i thatë dhe i barabartë.

2. Përzierja e materialit të stukimit ndërmjet fugave të pllakave: Pasi të hapni amballazhimin, materiali duhet të përziejhet me një mikser mekanik. Nëse është e nevojshme, përzierja mund të hollonhet: për përdorim me krahe me afersisht. 200ml uje për 20kg produkt, për të marrë konsistencën e dëshiruar.

3. Aplikimi me krahë i mbushjes së fugave:

- Vendosni sasi të mjaftueshme të perzjerjes, aq sa të mbushet e gjithë fuga totalisht, dhe shtypeni mirë në mënyrë që të siguroni një mbushje të hollë. Pas kësaj vendosni shiritin e fugës duke i ushtruar presion drejt bazës me një shpatull që përdoret për stukim. Prisni 24 orë deri sa të thahet plotësisht.
- Shtroni një shtresë të dytë të perberësimit mbi shiritin e fugës. Është e rëndësishme të shmangët dalja e stukos jashtë kanalit, zonës, së bashkimit. Prisni përseri 24 orë deri sa materiali të jetë plotësisht i tharë.
- Shtroni një shtresë të tretë të perberësimit për të bërë një kalim sa më të butë nga kanali I bashkimit në sipërfaqen e drejtë dhe të lemuar të places së gipsit. Vazhdojeni këtë shtresë në një distancë 50-60mm nga fundi i bashkimit midis pllakave.
- Për të përfituar një rezultat shumë të mirë, është e rekomandueshme patinimi i plote i të gjithë pllakave.

### **PATINIMI (STUKIMI) I MUREVE.**

- Shtrimi i shtresës së parë. Një shtresë me trashësi 1-3 mm duhet hapur. Levizja e mistrisë duhet të jetë nga poshtë lartë, me një pjerresë prej rreth 30% në lidhje me bazën. Filloni të rrafshoni murin me levizje rrethore vetëm në një drejtim (ose vetëm në të majtë ose në të djathtë, në asnjë rast në rreth të plote). Prisni sa sipërfaqja të jetë gjysëm e ngurtësuar, dhe pastaj vazhdoni me një mistri të pastër derisa sipërfaqja të bëhet plotësisht e lemuar. Me çdo levizje, sipërfaqja e llacit duhet të pastrohet me shpatull patinimi nga materiali që përdoret.
- Shtrimi i shtresës së dytë. Aplikoni një shtresë të dytë të perzjerjes pasi shtresa e parë të jetë plotësisht e tharë. Shtrojeni në të njëjtën mënyrë, por me një presion pak më shumë në mënyrë që të arrihet një trashësi mesatare e shtresës jo më shumë se 1 mm. Zbutini të gjitha kokëzatat dhe gropat me një ose dy levizje shtese. Nëse është e nevojshme, ilustroni shtresën me një letër zmerile të mirë pas fortësimit. Pastroni me kujdes sipërfaqen, dhe mbushni zonat me vrima me shpatull stuko dhe materialin e gatshëm, dhe përsërisni procedurën.

Kurdoherë që sipërfaqet permanente ekzistuese dëmtohen nga Kontraktori gjatë kryerjes së punimeve, ai duhet t'i riparojë, suvatojë, dhe t'i stukojë këto sipërfaqe deri në kufirin e sipërfaqeve të pa dëmtuara.

### **LYERJA ME BOJË**

Proçesi i lyerjes së sipërfaqeve të mureve dhe tavaneve kalon nëpër tre faza si më poshtë:

- Përgatitja e sipërfaqes që do të lyhet • Para lyerjes duhet të bëhet kruajtja e ashpër e bojës së mëparshme nga sipërfaqja e lyer, mbushja e gropave të vogla apo dëmtimeve të

sipërfaqes së murit me anë të stukimit me material sintetik dhe bërja gati për paralyerje. Përpara fillimit të procesit të lyerjes duhet të bëhet mbrojtja e sipërfaqeve që nuk do të lyhen (dyer, dritare, etj.) me anë të vendosjes së letrave mbrojtëse.

- Lyerja me bojë Në fillim bëhet përgatitja e përzierjes së bojës të lëngët e cila është e paketuar në kuti 5 – 15 litërshë. Lëngu i bojës hollohet me ujë në masën 20-30 %. Lyerja bëhet me dy duar. Norma e përdorimit për 1 litër bojë e holluar duhet të jetë sipër përcaktimeve të prodhuesit të bojës. Kjo normë varet nga ashpërsia e sipërfaqes dhe lloji i bojës së mëparshme. Në ndërtime të reja para lyerjes duhet të bëhet pastrimi i sipërfaqes që do të lyhet nga pluhurat dhe të shikohen dëmtimet e vogla të saj, të bëhet mbushja e gropave të vogla apo dëmtimeve të sipërfaqes së murit me anë të stukimit me material sintetik dhe bërja gati për lyerje (pjesë e procesit të patinimit/stukimit). Para lyerjes duhet të bëhet mbrojtja e sipërfaqeve që nuk do të lyhen (dyer, dritare, etj) me anë të vendosjes së letrave mbrojtëse.

## **DRITARE DURALUMINI**

Furnizimi dhe vendosja e dritareve, siç përshkruhet në specifikimet teknike me dimensione të dhëna nga kontraktori, përbëhen nga material alumini, profilet e të cilit janë sipas standarteve Europiane EN 573-3 dhe janë profile të lyera përpara se të vendosen në objekt. Ngjyra e dritares do të jetë sipas kërkesës së investitorit.

Korniza fikse e dritares do të ketë një dimension 61-90mm. Ato janë të siguruar me elemente që shërbejnë për vendosjen dhe ankorimin në strukturat e murit, si dhe me pjesët e dala që shërbejnë për rrëshqitjen e skeletit të dritares.

Forma e profilit është tubolare me qëllim që të mbledhë gjithë aksesorët e saj.

Profili i kanates të dritares do të jetë me dimensione të tilla 25 mm që do të mbulohet nga profili kryesor që do të fiksohet në mur.

Profilet e kornizave të lëvizshme kanë një dimension: gjërësia 32 mm dhe lartësia 75 mm të sheshta ose me zgjedhje ornamentale.

Të dyja korniza fikse ose të lëvizshme janë projektuar dhe janë bërë me dy profile alumini të cilat janë bashkuar me njëra tjetrën dhe kanë një fugë ajri që shërben si thyerje termike, ato janë të izoluara nga një material plastik 15 mm.

Profili është projektuar me një pjesë boshllëku qëndror për futjen e një mbështetëse lidhëse këndore (me hapësirë 18 mm të lartë nga xhami i dritares) dhe trolleys për rrëshqitjen e tyre. - Ngjitja është siguruar nga furça me një fletë qëndrore të ashpër.

Karakteristikat e ngjitësit kundër agentëve atmosferike duhet të jenë të provuar dhe të çertifikuar nga testimi që prodhuesit të këne kryer në kornizat e dritareve ose nga prodhuesit e profileve. –

Profilat e aluminit do të jenë të lyera sipas procesit të pjekjes lacquering. Temperatura e pjekjes nuk duhet të kalojë 180 gradë, dhe koha e pjekjes do të jetë më pak se 15 minuta. Trashësia e lacquering duhet të jetë së paku 45 mm. Pudrosja e përdorur do të bëhet me resins acrylic te cilesisë së lartë ose me polyesters linear. - Spesori i duraluminit duhet të jetë minimumi 1,5 mm.

Gjatë zëvendësimit të dritareve dhe dyerve Kontraktori duhet të sigurojë që të gjitha ato të zëvendësohen në të njëjtën ditë në mënyrë që ndërtesa të jetë e sigurt gjatë natës.

## **PROCEDURA TE TJERA:**

### **KONTROLI I ZHURMAVE DHE VIBRIMEVE**

Në rastet kur punimet e prishjes janë të lokalizuara pranë ndërtesave që janë në afërsi të kantierit të ndërtimit ose që janë në përdorim nuk do të lejohen zhurmat dhe vibrimet intensive gjatë orarit normal të punës në mënyrë që mbahen shqetësimet nga operacionet e ndërtimit në minimum. Koordinimi i punëve të tilla do të bëhet me Inxhinierin.

### **KONTROLI I PLUHRAVE**

Masat e duhura duhen marrë për të kontrolluar shpërhapjen e pluhurit dhe për të shmangur ndotjen nga pluhuri të zonës përreth. Këto masa duhet të jenë në përputhje me të gjitha rregulloret për kontrollin e pluhurave që imponohen nga agjencitë lokale të ndotjes së ajrit. Gjatë proceseve të prishjes në ndërtesat që janë ende në përdorim duhet të përdoren mbulesa për të mbrojtur zonat që janë ende në funksionim. Kur elementet që janë pjesë e prishjes përmbajnë fibra duhet të merren masa që të parandalohet inhalacioni i tyre nga popullata. Spërkatja me ujë i materialeve të tilla dhe përdorimi i maskave të pluhurit duhet të jetë një masë minimale e mbrojtjes. Shpimet në materialet fibroze janë të ndaluara.

### **MBROTJA OBJEKTET DHE PAJISJET EKZISTUESE**

Para fillimit të punimeve Kontraktori së bashku me Inxhinierin duhet të inspektojë dhe të identifikojë të gjitha objektet dhe pajisjet ekzistuese të cilat do të mbahen ose do të ripërdoren. Objektet dhe pajisjet ekzistuese do të: (a) lihen në vendin e tyre, apo (b), do të ripërdoren, apo (c) do të mbeten pronë e Klientit, dhe do të mbrohen duke përdorur mbulesa, mbështetje, apo mbështetje të përkohshme. Objektet të cilat dëmtohen gjatë kryerjes së punës, do të riparohen në gjendjen e tyre origjinale ose do të zëvendësohen me artikuj të rinj nga Kontraktori. Elementet strukturore nuk duhet të mbingarkohen. Mbështetje shtesë dhe përforcime duhet të sigurohen për të rritur stabilitetin e ndërtesave që mund të jenë dobësuar nga aktivitetet e prishjeve. Nesë vihen re humbje të stabilitetit strukturor (defleksione të tepërta, plasaritje, etj) Kontraktori duhet të marrë masa të menjëhershme për të siguruar evakuimin e menjëhershëm, mbylljen e zonës së ndërtimit

dhe të informojë Inxhinierin.

## **ULJA E MATERIALEVE**

Kur materialet apo mbetjet e ndërtimit ulen nga lartësitë, duhet treguar kujdes për të parandaluar lëkundjen, renien, dhe pozicionimin e tyre në një mënyrë që krijon rrezik për sigurinë e personelit, dhe të pasurisë publike.

## **PASTRIMI MBETJET DHE PLEHRAT**

Kontraktori nuk mund të shfrytëzojë kazanët e mbeturinave të komunitetit për hedhjen e mbeturinave të ndërtimit apo materialeve të dala nga rrënimi, por duhet të përdorë kontenerë të posaçëm për asgjësimin e çdo materiali të ndërtimit dhe duhet t'i transportojë mbetjet jashtë kantierit aq shpesh sa është e nevojshme. Largimi i mbeturinave dhe plehrave duhet të bëhet në mënyrë të tillë që do të mos lejohet derdhja e tyre nëpër rrugët apo zonat përreth kantierit. Çdo derdhje aksidentale e mbeturinave apo plehrave në rrugë apo në zonat përreth duhet pastruar.

Ndërtesa apo struktura dhe terreni urban duhet pastruar nga pluhuri dhe mbetjet e ndërtimit mbas përfundimit të punimeve të prishjes.

Në vijim janë disa foto të ambjenteve ekzistuese:



